

AKT- THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË

KUFIZUAR

“BIG MALLAKASTRA” Sh.p.k.

Midis:

1. Shoqëria **“BIGALB GROUP” shpk.** Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tillë pranë Regjistrimit Tregëtar në QKR, pajisur me Nipt **L11521002M** dhe seli në *Tiranë, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, kati 2*. Me përfaqësuese Ligjore Znj. Elona Koshi, e bija e Tekiut, e dtl. 04.09.1986, e lindur në Gramsh dhe banuese në Tiranë, Rruga “3 Dëshmorët”, Yzberisht. Madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 033400499 lëshuar më datë 06.06.2017.
2. Ilir SALIAJ, I biri I Kadriut, I datëlindjes 13.10.1963, I lindur në Kucovë dhe banues në Tiranë, Rr. Bogdanet, pallati nr.24, Shk.2, Ap.39, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 033855694 lëshuar datë 28.01.2019
3. Vladimir LLESHAJ, I biri I Vlashit, I datëlindjes 08.04.1978, I lindur në Prosek, Mirditë dhe banues në Tiranë, Rr. Peti, Liqeni I Thatë, pallati nr.2, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 035142585 lëshuar datë 20.11.2019.

Në bazë të legjislacionit shqiptar kanë vendosur me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, marrëveshjen për themelimin e shoqërisë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar **“BIG MALLAKASTRA” Sh.p.k.** e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar , si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijnë:

Neni 1

Te themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “Big Mallakastra” Sh.p.k. “Big Mallakastra” Sh.p.k. është një subjekt juridik Shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrijë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Shoqëria “Big Mallakastra” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet sipas ligjit.

Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Import-eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve, me shumicë dhe pakicë si:
 - Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial;
 - Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore;
 - Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtorale;
 - Tregëtim fruta-perime;
 - Tregëtim pije alkolike të ndryshme;
 - Tregëtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe femijë;
 - Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike;
 - Transport mallrash të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit;
 - Tregëtim automjetesh të cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to;
 - Tregëtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyrash etj;
 - Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative;
 - Tregëtimin e karburanteve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave të gazit dhe tregëtimin e tyre me pakicë.

Neni 4

- Shoqëria “Big Mallakastra” Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: **Ballsh, Rruga “Mallakastra”, Zona Kadastrale 1090, Nr. Pasurie 8/363.**

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë “Big Mallakastra” Sh.p.k. do të jetë **7,000,000 leke (shtatë milionë)** dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortakët.

Neni 6

Palët kontraktuese kanë rënë dakort të përcaktojnë kuotën e pjesmarrjes të seicilit ortak si më poshtë:

1. Shoqëria “BIGALB GROUP” sh.p.k..... 1 kuotë me vlerë të përgjithshme **2.800.000 lekë (dy milionë e tetëqind mijë)** që përbën **40% (dyzetë)** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ilir SALIAJ1 kuotë me vlerë të përgjithshme **1.400.000 lekë (një milionë e katërqind mijë)** që përbën **20% (njëzetë)** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Vladimir LLESHAJ,1 kuotë me vlerë të përgjithshme **2.800.000 lekë (dy milionë e tetëqind mijë)** që përbën **40% (dyzetë)** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë “Big Mallakastra” Sh.p.k. do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 8

I gjithë kapitali i vënë nga të dy ortakët themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

Neni 9

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregëtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga të dy ortakët. Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 10

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria do të ndahen pjesërisht ose totalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të tyre të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar si dhe nëpërmjet akteve të tjera noteriale apo kontratave të punës që ata do të realizojnë, pasi të jetë lënë një shumë mënjanë të paktën sa një e njëzeta e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë.

Neni 11

Ne kohën e prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit, kur nuk ka zgjatje afati kapitali i shoqërisë pasi të hiqen debitë e saj do të ndahet proporcionalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

Neni 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët, është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat Shqiptare, ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

Neni 13

Ortakët kanë këto të drejta dhe detyra themelore:

- të derdhin kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 6,
- të marrin pjesë në drejtimin e shoqërisë,
- të tërheqin fitimin e realizuar,
- të tërheqin aktivin resultant nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë,
- të ruajnë sekretin e aktivitetit të shoqërisë,
- të impenjohen për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Neni 14

Organet e shoqërisë “Big Mallakastra” Sh.p.k. janë:

- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Mario LAZRI**, për një afat 5 vjecar.

Neni 15

Shoqëria tregëtare private “Big Mallakastra” Sh.p.k. është person juridik shqipëtar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe vecanërisht ligji 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, të K. Civil si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 16

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr.7961, date 12.07.1995 (KODIT TË PUNËS), si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Neni 17

Mosmarrëveshjet e mundëshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate palët do ti zgjidhin në rrugë miqësore, në të kundërt kompetencat për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor përkatës.

Neni 18

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqipëtar.

Neni 19

Ky Akt-themelimi është përpiluar në tre kopje origjinale.

Datë 07/01/2020

ORTAKËT THEMELUES

Shoq. “BIGALB GROUP” Sh.p.k.

ILIR SALIAJ

VLADIMIR LLESHAJ

Përfaqësuese Ligjore

ELONA KOSHI

Elona Koshi



Ilir Saliaj



Vladimir Lleshaj

